



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 772/5 prot.

Datë 22.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 528/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.04.2026 me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59857-08-29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”, me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
- Autoriteti Kontraktor:** Identitek Sh.a. Adresa: Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “FILARA” SHPK, me Nipt. K51611059N  
Adresa: Rruga Kavajes, Ish kombinati Misto Mame , Prane fabrikes Kaon.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01-09-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59857-08- 29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”, me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II.2. Në datën 14-11-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 09.01.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“ ALBDESIGN PSP” SHPK	0.00 Skualifikuar
2.“ FILARA” SHPK	2,050,020.00 Skualifikuar
(Pas verifikimit ne sistem e SPE te APP-së rezulton se Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër “FILARA” shpk, me NIPT K51611059N, përjashtohet – 5(pesë) muaj (duke filluar nga data 20.11.2025 - 20.04.2026)	
3.“ DIXHI PRINT - AL” SHPK	2,110,200.00 Skualifikuar
(Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se ai është në përputhje me atë të dorëzuar elektronikisht, por dokumentet që përmbushin e mbështesin gjendjen faktike në kohën e ofertimit të tij.Përkatesisht:1. Certificate ISO 9001:2015, 2. Certificate ISO 45001:2018, 3. Certificate ISO 14001:2015 nuk janë kopje origjinale ose te noterizuara.Në DT citohet: Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Dokumentacioni fizik i paraqitur është kopje me ngjyrë, si pasojë nuk përmbush kushtet për kualifikim)	
4. “ Inpress” SHPK	2,248,415.25 Kualifikuar
5. “ OPTIMA COMMUNICATION” SHPK	2,248,415.25 Kualifikuar
6.“ F & M Reklama” SHPK	2,691,000.00 Kualifikuar

II.4 Në datën 16-01-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit te procedurës në sistemin e prokurimeve elektronike dhe APP, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6261, datë 20.01.2026 dhe me nr. protokollit 168/2026 datë 20.01.2026 e operatorit

ekonomik “Filara” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF59857-08-29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”, me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.168/1 prot, datë 21.01.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Filara” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7 Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se me shkresën e protokolluar me tonën nr.168/2, datë 23.01.2026,, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.8. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 76/8/25 prot., datë 27.01.2026, protokolluar me tonën me nr.168/3 prot., datë 02.02.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Filara” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.9. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6262, datë 20.01.2026 dhe me nr. protokoll 169/2026 datë 20.01.2026 e operatorit ekonomik “DIXHI PRINT - AL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59857-08-29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”, me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II.10. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.169/1 prot, datë 21.01.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “DIXHI PRINT - AL” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11 Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se me shkresën e protokolluar me tonën nr.169/2, datë 23.01.2026, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.12. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 76/6 prot., datë 27.01.2026, protokolluar me tonën me nr.169/3 prot., datë 02.02.2026, vendimin e KSHA-së së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “DIXHI PRINT” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës së sipërcituar.

II.13. Në datë 13.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.255/2026 ku vendosi si më poshtë vijon:

“

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59857-08- 29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”, me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dixhi Print” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke kualifikuar operatorin ekonomik “Dixhi Print” SHPK në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dixhi Print” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Filara” Shpk.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

II.14. Në datë 25.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.314/2026 ku vendosi si më poshtë vijon:

“

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59857-08- 29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”,

*me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.*

2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

II.15. Në datën 10-03-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit te procedurës pas rivlerësimit të saj në sistemin e prokurimeve elektronike dhe APP, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.16. Në datën 11.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. elektronik A/2026/6408 dhe me nr. 772/2026 protokoli, datë 11.03.2026 e operatorit ekonomik “FILARA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59857-08 29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”, me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II.17. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.772/1 prot, datë 12.03.2026, që lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “FILARA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.18. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit, ka përcjellë me shkresën nr. 76/11 prot., datë 02.04.2026, protokolluar me tonën me nr.772/2 prot., datë 03.04.2026, trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Filara” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. (neni 24 i LPP).

III.1.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Filara” SHPK për shfuqizimi e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur përmes të cilës ka parashtruar *“Sipas informacionit Zyrtarë si më sipër cituar, arsyeja e skualifikimit tonë ishte vetëm përjashtimi jonë nga procedura e prokurimit publik pas Vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 73, datë 20.11.2025. Përsa I përket Skualifikimit tonë nga Procedurat e Prokurimit Publik, ju bëjmë me dije se: Vendimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 73, datë 20.11.2025 e kundërshtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, ku deri zgjidhjen përfundimtare të çështjes për kundërshtimin e vendimit, kemi kërkuar edhe Sigurimin e Padisë. Në datën 24.02.2026 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në Vendimin Nr.Regj.Them 1160/6656 me palë paditëse Shoqërinë Filara Sh.p.k. dhe të Paditur Agjencia Prokurimit Publik ndër të tjera ka vendosur: Pezullimin e zbatimit të Aktit Administrativë Vendimit Nr. 73 datë 20.11.2025 I Agjencisë së Prokurimit Pulik Në kuptim të legjislacionit procedural administrativ, vendimi për sigurimin e padisë ka efekt të menjëhershëm dhe detyruet për palët, si dhe synon të neutralizojë përkohësisht pasojat juridike të aktit administrativ të kundërshtuar, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes me vendim gjyqësor të formës së prerë.”*, KPP nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj dhe argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoi” të vendimit nr.255/2026, datë 13.02.2026, kjo në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, dhe merr vendime të cilat janë administrativisht përfundimtare (neni 24/1 i LPP).

III.1.2. KPP, gjen me vend të theksojë gjithashtu se ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë. KPP në cilësinë e organit më të lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse.

Akoma më tej, bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe përkatësisht në nenin 121 të tij, ashtu sikundër përcaktohet edhe në dispozitivin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë, në të gjitha rastet kur mendojnë se vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik kanë cënuar interesat e tyre të ligjshëm, mund të ndjekin hapat e mëtejshëm, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

III.1.3. Nga shqyrtimi i pretendimit të mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Filara” SHPK, konstatohet se ky i fundit ngre pretendime për të cilat Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur dhe ka marrë vendimin nr. 255/2026, datë 13.02.2026 për ankesën e parë të paraqitur për këtë procedurë prokurimi me nr. ankimi elektronik A/2026/6261, datë 20.01.2026 dhe me nr. protokollin 168/2026 datë 20.01.2026 e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, që lidhet me vendimmarrjen e parë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tyre, në

procedurën e mësipërme të prokurimit, pretendime këto të cilat pas shqyrtimit nga KPP janë argumentuar me arsyetimin si në pikën III.1.9. të vendimit K.P.P. 255/2026 datë 13.02.2026.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret pretendimi i mësipërm i parashtruar në ankesë nga operatori ekonomik “Filara” SHPK përbën “gjë të gjykuar”, për të cilat Komisioni është shprehur në vendimin K.P.P 255/2026 datë 13.02.2026 mbi bazën e ankesës së parë të paraqitur për këtë procedurë prokurimi me nr. ankimi elektronik A/2026/6261, datë 20.01.2026 dhe me nr. protokoli 168/2026 datë 20.01.2026 e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, që lidhet me vendimmarrjen e parë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur prej tyre, për procedurën në fjalë, vendim i cili në bazë të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, përkatësisht nenit 30 pika 2, është administrativisht përfundimtar. Në këtë kuptim, kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, ipso lege, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim.

III.1.5. KPP thekson faktin se fuqia e “res judicata” (gjësë së gjykuar) mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ përfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes së pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij.

III.1.6. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 30 pika 2 të Ligjit nr.162/2020, ku përcaktohet shprehimisht se: “Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji”, gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Filara” SHPK në thelb përbëjnë rishikim të vendimit K.P.P. 255/2026 datë 13.02.2026, e cila referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik nuk mund të kërkohet nga operatorët ekonomikë.

Sa më sipër arsyetuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Filara” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-59857-08- 29-2025, me objekt “Shërbim Brandimi”, me fond limit 2,997,887.00 Lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 14-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
4. Autoriteti kontraktor të vijoj me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Filara” Shpk.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

